



Prezantim i Kryetares së AMF-së, Enkeleda Shehi, në Konferencën e dytë “Mbikëqyrja Globale e Sigurimeve - Tendencat dhe Zhvillimet” organizuar nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) dhe Qendra Ndërkombëtare për Rregullimin e Sigurimeve (ICIR)

Vijon në faqen 2



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar - gusht 2013

Vijon në faqen 5

Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30 qershor 2013

Vijon në faqen 6

Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 qershor 2013

Vijon në faqen 6

ZHVILLIME TË TJERA

Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi u takua me drejtorin e Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë, me fokus mbikëqyrjen e përbashkët të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri (30 gusht 2013)

Vijon në faqen 7

Zhvillohet Konferenca e 38-të Vjetore e IOSCO-s (15-19 shtator 2013, Luksemburg)

Vijon në faqen 8

Diskutim mbi rreziqet në tregjet në zhvillim në dritën e kushteve aktuale të tregut global - Takim i Komitetit të Tregjeve në Zhvillim (Growth and Emerging Markets Committee, GEM) (15 shtator 2013)

Vijon në faqen 9

LAJMET NGA RAJONI

Azerbajxhan *Vijon në faqen 12*

Kroaci *Vijon në faqen 12*

Moldavi *Vijon në faqen 13*

Rumani *Vijon në faqen 13*

Turqi *Vijon në faqen 14*

Shoqëritë e sigurimeve janë aktorë ndërkufitarë dhe ky globalizim në rritje i veprimtarisë së sigurimeve kërkon një rregullim global

Prezantim i Kryetares së AMF-së, Enkeleda Shehi në Konferencën e dytë “Mbikëqyrja Globale e Sigurimeve – Tendencat dhe Zhvillimet”, organizuar nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) dhe Qendra Ndërkombëtare për Rregullimin e Sigurimeve

Në datat 5 - 6 shtator 2013, u zhvillua në Frankfurt konferenca e dytë me temë “Mbikëqyrja Globale e Sigurimeve – Tendencat dhe Zhvillimet”. Aktiviteti u organizua nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) dhe Qendra Ndërkombëtare për Rregullimin e Sigurimeve (ICIR). Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të niveleve më të larta nga autoritete rregullatore financiare, institucione financiare ndërkombëtare, të industrisë së sigurimeve dhe nga bota akademike.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u përfaqësua nga Kryetarja Enkeleda Shehi, e cila ishte njëkohësisht edhe anëtare në panelin e sesionit të datës 6 Shtator me temë: “Perspektiva e sigurimeve”.

Në fjalën e saj, Kryetarja Shehi trajtoi (i) situatën ekzistuese në kërkim të standardeve globale, (ii) sfidat e hartimit të standardeve të reja apo të zbatimit të atyre ekzistuese, (iii) si Shqipëria i zbaton standardet globale të sigurimeve, dhe (iv) rëndësinë e bashkëpunimit me bankën Botërore për zbatimin e mbikëqyrjes me bazë riskun në ekonomitë në zhvillim.

Më poshtë është një përmbledhje me shkurtime e fjalës së Kryetares së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në këtë konferencë.

Për të lexuar të plotë fjalën e mbajtur klikoni në <http://amf.gov.al/files/File/EIOPA%20Q%20al.pdf>

Globalizimi tani është një proces i pakthyeshëm dhe një realitet i cili ushtron trysninë e vet mbi juridiksionet tona, pavarësisht nivelit të zhvillimit dhe sofistikimit të tregjeve financiare. Të qenit një juridiksion efektiv dhe kompetitiv është thelbësor në këtë mjedis të ri, për t'i zvogëluar rreziqet që paraqet ai dhe për të përfituar nga mundësitë që të jep. Edhe vetë siguresve u duhet të përballen me këtë mjedis gjithnjë e në ndryshim, nëse duan të mbeten konkurrues.

Tashmë shoqëritë e sigurimeve janë aktorë ndërkufitarë dhe ky globalizim në rritje i veprimtarisë së sigurimeve kërkon një rregullim global. *Arritja e një regjimi rregullator i cili të jetë i drejtpeshuar mes mbrojtjes dhe aftësisë konkurruese përbën një sfidë madhore për çdo juridiksion.* Nga ana tjetër, ngritja e një infrastrukture financiare të shëndoshë dhe e një tregu sigurimesh të rregulluar në mënyrë efikase do të jepte fryte përmes thithjes së kapitalit. Pra, vjen një pikë dhe regjimet rregullatore konkurrojnë mes tyre, gjithmonë duke iu dashur të konvergjojnë nëse duan të mundësojnë njëtrajtshmëri në një mjedis global.

Konvergjencia ndërkombëtare e standardeve globale është thelbësore në këtë mjedis që ndryshon në vazhdimësi. “IFRS” dhe “Solvency II” janë vetëm disa prej shembujve të mirë të punës së pamasë për arritjen e konvergjencës me standardet e reja globale në këto fusha kryesore. Saç është e vështirë arritja e njëtrajtshmërisë, në periudhën afatgjatë, standardet globale duhen vlerësuar kundrejt kontributit që mund të japin për rritjen e transparencës në të gjitha juridiksionet, uljen e kostos së kapitalit apo vendosjen e kushteve të barabarta të lojës. Këto janë disa prej përfitimeve reale në drejtim të të cilave duhet kanalizuar mekanizmi i vendosjes së standardeve në çdo juridiksion.

Sidomos, tregjet në zhvillim përballen me një sfidë më të vështirë në rrugën e tyre drejt zbatimit të një kuadri ligjor të brendshëm e të hapur, po të kemi parasysh veçantitë apo rrethanat e veçanta që e karakterizojnë secilin treg. Rruga që duhet ndjekur është të synohet për politika të cilat i zvogëlojnë pikat e dobëta dhe të ndiqet një qasje me efektivitet të kostos në përgjigje të kriterëve të shëndosha ekonomike gjatë hartimit të rregulloreve të reja, e të mos mbahet një qëndrim pasiv duke reaguuar pas zhvillimeve. Përkundër faktit që konkurrenca me tregjet e zhvilluara, sa i takon efikasitetit dhe novacionit, duket jorealiste, nëse nuk arrihet të njihet integrimi i tregjeve pa kufij nga ana e ligjvënësve, atëherë kjo mund të ketë pasoja negative në periudhën afatgjatë. *Kjo mund të përbëjë edhe një çështje botërore dhe një argument të vlefshëm për fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit global.*

Parë nga këndvështrimi i një tregu në zhvillim, ngritja e kanaleve të bashkëpunimit, si në nivel dypalësh ashtu edhe në nivel rajonal, dhe bashkëpunimi me organet që vendosin standardet ndërkombëtare jo vetëm që mundëson bashkërendim më të mirë të veprimtarisë rregullatore dhe mbikëqyrjes ndërkufitare, por është gjithmonë një mënyrë e efektshme për përqafimin e praktikave më të mira dhe për të përfituruar në të njëjtën kohë nga shkëmbimi i njohurive dhe përvojave. Pas krizës së fundit botërore financiare, ndjesia e përgjithshme është se ne, si autoritete rregullatore, do të donim të kërkonim më shumë standarde rregullatore. Në të vërtetë, njëri prej aspekteve kyçe të kundërpërgjigjes politike globale ndaj krizës ka qenë fuqizimi i rregullimit financiar. Thjesht versioni i rishikuar i “ICP”-ve është dëshmi e kësaj kundërpërgjigjeje përmes politikave. Kjo ndjesi është më e fortë në një mjedis juridik më të dobët, ku logjika e thjeshtë dhe gjykimi i shëndoshë nuk janë aq të efektshëm sa në tregjet e zhvilluara. E megjithatë, të gjithë e dimë se vetëm kuadri rregullator nuk mjafton, nëse ai nuk zbatohet siç duhet, në kohë dhe me konsekuencë.

Banka Botërore është një partner shumë i rëndësishëm strategjik i AMF-së qysh prej themelimit të këtij autoriteti në vitin 2006. Njëri prej projekteve madhore të zhvilluar me asistencën e Bankës Botërore dhe të financuar nga “First Initiative” është “Mbikëqyrja e efektshme”.

Projekti ka filluar në vitin 2008, me qëllim fuqizimin e metodikës së mbikëqyrjes, duke synuar një qasje të fokusuar në risk.

Një ndër projektet madhore zhvilluar me asistencën e Bankës Botërore dhe të financuar nga “First Initiative” është “Mbikëqyrja e efektshme”

Manuali i Mbikëqyrjes me Fokus Riskun do të kontribuojë në reformimin e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve duke e fuqizuar më tej atë dhe duke bërë atë më efikase

Puna dyvjeçare për hartimin e metodikës së re të mbikëqyrjes me fokus riskun ka qenë e suksesshme falë bashkëpunimit të frytshëm ndërmjet ekspertëve të Bankës Botërore dhe mbikëqyrëse të AMF-së. Gjatë hartimit të metodikës së re janë mbajtur në konsideratë edhe modele të tjera nga vende të cilat kanë filluar ta zbatojnë më parë këtë qasje të re të mbikëqyrjes. Vëmendje e veçantë i kushtohet edhe përshtatjes së metodikës me kushtet e tregut shqiptar të sigurimeve.

Ne jemi të bindur se Manuali i Mbikëqyrjes me Fokus Riskun do të kontribuojë në reformimin e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve duke e fuqizuar më tej atë dhe duke bërë atë më efikase. Koncepti bazë i metodikës së re është identifikimi i fushave me risk të lartë në veprimtaritë e shoqërive të sigurimeve dhe, nëse del nevoja, puna me administratorët e tyre për t'i zvogëluar risqet brenda kufijve të pranueshme. *Synimi është të parandalohen problemet financiare përpara se të ndodhin, e jo të zgjidhen pasi të kenë ndodhur.* Në varësi të profilit të veçantë të riskut, AMF do të vendosë prioritetet e mbikëqyrjes dhe shkallën e ndërhyrjes në shoqëritë, me idenë për ta rikthyer riskun në nivele që janë të pranueshme për qëllimin e mbikëqyrjes. Në këtë mënyrë, AMF do të bëjë një shpërndarje më efikase të burimeve, duke u larguar nga qasja klasike e bazuar në rregulla.

Prej muajit tetor 2011, Bordi i AMF-së ndjek parimin e kësaj metodike të re për mbikëqyrjen e sigurimeve, përmes miratimit të Manualit të Mbikëqyrjes me Fokus Riskun dhe të Planit të Zbatimit Strategjik. Së bashku me metodikën, është hartuar edhe një projektligj i ri për sigurimet, për të vënë në jetë këtë metodikë, projektligj i cili është çuar për miratim. Ky projektligj nuk është aprovuar ende nga Kuvendi, duke shkaktuar kështu një mbetje pas sa i takon vënies në zbatim të metodikës së re. Shpresojmë se do të miratohet deri në fund të vitit 2013.

Është e rëndësishme të theksohet se ecja në drejtim të mbikëqyrjes së mbështetur në risk është një drejtim shumë i rëndësishëm strategjik dhe kjo do të zbatohet në periudhën afatgjatë në tregun e sigurimeve. *Si pasojë, vënia në zbatim do të jetë graduale në mënyrë që t'i jepet mundësi tregut dhe autoritetit rregullator t'i bashkërendojnë veprimet e tyre dhe të ngrenë kapacitetet dhe infrastrukturën e duhur për të ecur përpara.*

Kështu AMF do të jetë në gjendje t'i përcaktojë qartë drejtimet e veta strategjike në kuadër të fuqizimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, në mënyrë që t'u afrohet sa më shumë praktikave më të mira në këtë fushë dhe të përqafojë prirjet globale në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve. Për ta mbyllur, përvoja me Bankën Botërore ka qenë shumë pozitive dhe jo vetëm për këtë temë për të cilën po flasim. Banka Botërore e ka asistuar vazhdimisht AMF-në, edhe në hartimin e akteve ligjore në fushën e fondeve të pensioneve vullnetare private, si edhe kohët e fundit ka ndihmuar në përgatitjen e një udhërrëfyese për liberalizimin e tregut të sigurimit TPL në sektorin e transportit.

AMF është anëtarësuar në IAIS në vitin 2001, prej atëherë është përpjekur të përmbushë standardet globale të sigurimeve dhe të ndjekë rishikimin e tyre. Kështu, *ndryshimet në botën e rregullimit të sigurimeve shkaktajnë*

ndryshime edhe në botën tonë. Në parim, i konsiderojmë standardet globale si një strategji të mbikëqyrjes së efektshme dhe përpigemi t'i vëmë në zbatim si në përmbajtje ashtu edhe në frymë.

Së pari dhe mbi të gjitha, "ICP"-të shërbejnë gjithmonë si një tregues krahasimi për kuadrin ligjor dhe rregullator në Shqipëri.

Ky proces nuk mbyllet këtu. Megjithëse legjislacioni është i nevojshëm për të futur përmbajtjen e "ICP"-ve, ai pasohet me aktivitete të tjera për të qenë në gjendje të vihet në jetë vetë fryma e "ICP"-ve. Paralelisht me punën për legjislacionin e ri për sigurimet, brenda organizatës sonë e kemi riorientuar të gjithë mendimin e misionit dhe synimeve tona. Tani e kemi përqendruar më shumë punën tek nxitja e besimit tek tregu i sigurimeve, në dallim nga besimi tek sigurues individualë, dhe veprimtaria e mbikëqyrjes është realizuar nga këndvështrimi i stabilitetit financiar, në përputhje me frymën që përcjellin "ICP"-të e rishikuara.

Procesi i zbatimit të "ICP"-ve i ngjan një qarku të marrjes së reagimeve. Përpjekjet për të përmbushur disa "ICP" të caktuara na kanë ndihmuar të kuptojmë sa e rëndësishme është sigurohet përmbushja në çdo aspekt të "ICP"-ve të tjera. Për të qenë më konkretë, projektligji për veprimtarinë e sigurimit e ka bërë krejt të qartë se duhen fuqizuar kapacitetet administrative të AMF-së. Kështu, konstatimet kryesore të vetëvlerësimit të "ICP" 1 dhe 2 na kanë shërbyer si lëndë e parë për të propozuar shtesa dhe ndryshime në Ligjin për AMF-në, me synim fuqizimin e pavarësisë, për të mundur të rekrutojmë dhe mbajmë punonjës cilësorë, të risim stabilitetin e burimeve tona financiare dhe fleksibilitetin e strukturës organizative për t'iu përgjigjur menjëherë këtij mjedisi dinamik.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2013

Tregu i sigurimeve u ul me 8.39% në janar-gusht 2013. Vlera e primit të shkruar bruto në periudhën janar-gusht 2013 arriti në 5.35 miliardë lekë, ndërsa numri i policave të sigurimit pati një ulje prej 4.20% dhe arriti në 666,819 polica sigurimi.

Sigurimi Jo-Jetës u ul me 11.00% në janar-gusht 2013, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa sigurimi i Jetës u rrit me 11.99%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë, dëmet e paguara bruto regjistruan një ulje prej 4.50% në krahasim me periudhën janar-gusht 2012.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Sigurimi i detyrueshëm për periudhën janar-gusht 2013 përbën 45.75% të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës. Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën 2.44 miliardë lekë, me një ulje prej 15.20% krahasuar me janar-gusht 2012.


Tregu i sigurimeve
u ul me 8.39% në
janar-gusht 2013

Jo-Jeta, të tjera

Klasa të tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës përbëhen nga *zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë*, të cilat zunë 22.43% të tregut të Jo-Jetës.

Klasat, *sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme*, së bashku zunë 14.48% të tregut të Jo-Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-gusht 2013



Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30 qershor 2013

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013 në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në 30.06.2013 tregon një total asetesh nën menaxhim prej 352.50 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 69.49 milionë lekë (24.55%).

E shprehur në euro, totali i asetëve nën menaxhim është 2.50 milionë euro. (Sipas kursit zyrtar të këmbimit, "fiksi" 28.06.2013 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 140.96 lekë, www.bankofalbania.org)

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve në 30.06.2013 ishte 7,784 anëtarë duke shënuar rritje prej 6.91% krahasuar me fundin e vitit 2012.

Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 qershor 2013

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013 në tregun e Fondeve të Investimeve ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht "Fondi i Investimeve Raiffeisen Prestigi" dhe "Fondi Raiffeisen Invest Euro".

Tregu i pensioneve private vullnetare në 30.06.2013 u rrit me rreth 69.49 milionë lekë (24.55%)

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të Investimeve në 30.06.2013, vlera neto e asetëve të fondeve, arriti 29.30 miliardë lekë me një rritje prej 83.01%, krahasuar me 31.12.2012.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 84.96% të asetëve të fondeve, me rritje prej 118.20%, krahasuar me 31.12.2012.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 30.06.2013 është 17,933.

ZHVILLIME TË TJERA

Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleida Shehi u takua me Drejtorin e Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë, me fokus mbikëqyrjen e përbashkët të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri

Në kuadër të bashkëpunimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), një delegacion nga ky institucion, bëri një vizitë pune në datën 30 gusht 2013, pranë zyrave të AMF-së.



Znj. Enkeleida Shehi dhe Z. Peter Braumüller gjatë takimit në Tiranë

Delegacioni kryesohej nga Z. Peter Braumüller, Drejtor i institucionit homolog austriak për Mbikëqyrjen e Tregjeve Financiare dhe njëkohësisht anëtar i Bordit të EIOPA (Autoriteti

Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale) dhe Kryetar i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime, ku AMF aderon që nga viti 2001.

Vizita e Z. Braumüller në Shqipëri u zhvillua në kuadër të forcimit të marrëdhënieve me AMF-në, në funksion të mbikëqyrjes së përbashkët të grupeve austriake të sigurimeve që operojnë në Shqipëri. Dy institucionet kanë një marrëveshje mirëkuptimi që prej vitit 2009, e lidhur menjëherë pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri, e cila është konkretizuar me takime të ndërsjellta, shkëmbim përvoje dhe asistencë teknike në realizimin e projekteve të rëndësishme.

Në takim u diskutuan çështje të rëndësishme, që lidhen me zhvillimet e fundit ligjore e të mbikëqyrjes së tregjeve respektive të sigurimit dhe identifikimin e fushave për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis dy institucioneve.

Vizita e Z. Braumüller në Shqipëri u zhvillua në kuadër të forcimit të marrëdhënieve me AMF-në, në funksion të mbikëqyrjes së përbashkët të grupeve austriake të sigurimeve që operojnë në Shqipëri

Po kështu, u morën angazhime për mbikëqyrjen e përbashkët të grupeve austriake të sigurimeve, të cilat kanë prezencë dominuese në tregun shqiptar të sigurimeve, proces ky që do të koordinohet në nivel rajonal nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Austrisë.

Zhvillohet Konferenca e 38-të Vjetore e IOSCO-s

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (*International Organization of Securities Commissions, IOSCO*) zhvilloi gjatë periudhës 15-19 shtator 2013 në Luksemburg, Konferencën e 38-të Vjetore. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, si anëtar me të drejta të plota i kësaj organizate, u përfaqësua në këtë konferencë nga Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit, Z. Rinald Guri, Drejtor i Departamentit të Kërkimit, Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës dhe Znj. Flora Musta, Drejtore e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit.



Gjatë seancave plenare, ashtu edhe në mbledhjet e grupeve të punës, diskutimet u fokusuan në sfidat e autoriteteve mbikëqyrëse në kushtet e krizës financiare botërore. Kryetari i Bordit të IOSCO-s, Greg Medcraft tha se IOSCO po luan një rol gjithnjë në rritje duke iu përshtatur dhe përballur me sfidat e shumta që rregullatorët e letrave me vlerë hasin sot. Konferenca synoi përcaktimin e një raporti të drejtë midis rregullimit e mbikëqyrjes nga njëra anë dhe mbrojtjes së investitorëve nga ana tjetër.

Anëtarët e IOSCO-s diskutuan mbi të ardhmen e tregjeve të letrave me vlerë e investimeve në to. Midis të tjerave, ata:

- Konfirmuan vendosmërinë për të punuar së bashku për të identifikuar rreziqet e mundshme në një mënyrë proaktive dhe me vështrim drejt zhvillimeve të ardhme;
- Mbështetën rolin në rritje të IOSCO-s në promovimin e investimeve afatgjata në tregjet e kapitaleve, në fusha të tilla si obligacionet e korporatave, financat e SME-ve (ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme), Financat Islamike, etj;
- Diskutuan nevojën për punë të mëtejshme në përmirësim të cilësisë së auditimit;
- Veçuan rëndësinë në rritjet e zbatimit të parimeve dhe rekomandimeve të IOSCO-s për të promovuar tregjet e mirërregulluara.

Gjatë konferencës u zhvilluan dhe mbledhjet e komiteteve të veçanta të IOSCO-s dhe u diskutua ndër të tjera edhe mbi:

- Vendosjen e standardeve, si dhe iniciativën për të monitoruar zbatimin e principeve dhe rekomandimeve;

Anëtarët e IOSCO-s diskutuan mbi të ardhmen e tregjeve të letrave me vlerë e investimeve në to

- Rolin e IOSCO-s dhe progresin e deritanishëm në reformën e deleguar nga udhëheqësit e G20 e cila koordinohet nga Bordi i Stabilitetit Financiar (*Financial Stability Board*) për zhvillimin e metodologjive për identifikimin e instituteve financiare jo-bankare me rëndësi sistemike (*non-bank SIFIs*);
- Tregjet e kapitaleve dhe investimet afatgjata;
- Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS). Bordi aprovoi një deklaratë të përbashkët të IOSCO-s dhe Fondacionit IFRS duke vendosur protokollin e bashkëpunimit të tyre në zhvillimin e zbatimit të IFRS-së, me besimin se zbatimi i tyre do të lehtësojë transparencën në tregjet e kapitaleve;
- Identifikimin e risqeve sistemike. Bordi vendosi publikimin e “IOSCO Risk Outlook”;
- Edukimin e investitorëve dhe edukimin financiar në tërësi;
- Punën e kryer nga Grupi i Punës për rregullimin e veprimtarive ndër-kufitare (*Cross-Border Regulation*);
- Krimet kibernetike në tregjet financiare si rreziqe të reja. Pjesëmarrësit specifikuan efektin serioz që të tilla krime kanë në integritetin dhe efektshmërinë e tregjeve globale.

Në mbledhje u diskutuan edhe çështje organizative si aprovimi i anëtarëve të rinj të IOSCO-s, ndryshimet në përbërjen e Bordit, masat për promovimin e standardeve të IOSCO-s edhe tek vendet jo-anëtare, krijimin e një fondacioni për ngritjen e kapaciteteve, etj.

IOSCO do të zhvillojë Konferencën e 39-të Vjetore në Brazil në 2014.

Diskutim mbi rreziqet në tregjet në zhvillim në dritën e kushteve aktuale të tregut global - Takim i Komitetit të Tregjeve në Zhvillim (*Growth and Emerging Markets Committee, GEM*)

15 shtator, Luksemburg

*Diskutimi mbi rreziqet në tregjet në zhvillim në dritën e kushteve aktuale të tregut global zgjoi mjaft interes dhe tërhoqi pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të Komitetit për Tregjet në Zhvillim (*Growth and Emerging Markets Committee, GEM*) duke përfshirë këtu edhe vende si Afrika e Jugut, Brazili, India, Indonezia, Kina, dhe Turqia.*

Disa nga çështjet themelore të theksuar nga anëtarët e Komitetit GEM ishin:

Reversal i flukseve të kapitalit të huaj

Ka pasur shqetësime të menjëhershme te anëtarët për shkak të rritjes, kohët e fundit, të paqëndrueshmërisë që ka prekur ekuitetet, tregjet e

Në mbledhje u diskutuan edhe çështje organizative si aprovimi i anëtarëve të rinj të IOSCO-s, ndryshimet në përbërjen e Bordit, masat për promovimin e standardeve të IOSCO-s edhe tek vendet jo-anëtare, krijimin e një fondacioni për ngritjen e kapaciteteve, etj.

bonove dhe monedhat lokale në juridiksionet përkatëse.

Anëtarët pranojnë se paqëndrueshmëria në rritje në tregjet në zhvillim, në një masë të madhe, ka qenë i nxitur nga pritjet e rimëkëmbjes globale dhe likuiditetit, veçanërisht në tregjet e zhvilluara, të cilat çuan në ndryshime në drejtim të lëvizjes së flukseve të kapitalit. Është ndjerë tërheqja e kapitalit të huaj nga tregjet në zhvillim, të cilat, në vitet e fundit, kanë shijuar rritje relativisht të qëndrueshme dhe zhvillim.

Tregjeve në zhvillim kanë treguar elasticitetit

Përpjekjet e bëra nga tregjet në zhvillim në vitet e fundit për të thelluar dhe zhvilluar më tej tregjet e kapitalit, veçanërisht ato të obligacioneve të korporatave, si edhe përpjekjet për forcimin e kuadrit rregullator dhe strukturave institucionale, një masë të madhe kanë zbutur ndikimin e luhatshmërisë së shtuar në tregjet e tyre. Disa anëtarë, theksojnë gjithashtu se masat e kohëve të fundit të marra nga Rezerva Federale e SHBA të cilat fillimisht kanë rezultuar në një rritje të luhatshmërisë në tregjet në zhvillim, mund të zbatohen gradualisht, duke lejuar kështu një reagim normal nga pjesëmarrësit e tregut.

Tregjet në zhvillim
kanë treguar
elasticitet

Në këtë kontekst, rregullatorët kanë rol për të luajtur, në monitorimin e pjesëmarrësve të tyre të tregut, dhe të vlerësuar shkallën në të cilën ato mund të jenë ndikuar nga rritja në paqëndrueshmërinë e tregut. Për shembull, disa kompani të mëdha publike në një treg të madh në zhvillim, pësojnë humbje, kur paqëndrueshmëria e kursit të këmbimit rritet për shkak të mungesës së sistemeve të duhura të menaxhimit të rrezikut. Humbjet e tilla mund të minojnë besimin e investitorëve dhe të ngadalësojë përpjekjet në rritje të tregjeve. Për më tepër, ata mund të rrezikojnë reputacionit e rregullatorit. Veçanërisht, menaxherët e fondeve të investimeve duhet të monitorohen për të siguruar që ato janë në përputhje me politikën e tyre të likuiditetit, në mënyrë që të shmangin mospërputhjen e aktiveve me redemptions, dhe kjo madje edhe në skenarë hipotetikë.

Anëtarët gjithashtu theksuan edhe nevojën për bashkëpunim më të madh në shkëmbimin e përvojave, veçanërisht gjatë periudhave të stresit tregut. Anëtarët gjithashtu bënë thirrje për punë më të detajuar kërkimore dhe lidhur me rrezikun për tregjet në zhvillim nga Njësia e Kërkimit pranë Sekretariatit të Përgjithshëm IOSCOs, si edhe për të shqyrtuar mundësinë e bashkëpunimit me FMN-në në këtë fushë.

Pjesëmarrja investitorëve të huaj dominues në Tregjet e Kapitaleve një shqetësim gjatë stresit tregut

Në disa nga juridiksionet e vendeve e tregjeve në zhvillim të G-20-s, pjesëmarrja e investitorëve të huaj në tregjet e kapitalit është përafërsisht 60%. Kjo përbën një shqetësim pasi ndikimi rreziku nga tërheqja e fondeve nga ana e investitorëve të huaj është relativisht e lartë. Në këtë drejtim, anëtarët theksuan përfitimet e pjesëmarrjes në rritje të investitorëve institucionalë dhe nga tregtia me pakicë në tregjet e kapitalit vendas, të cilat mund të veprojnë si një tamponë kundër tërheqjes së papritur dhe të fondeve të mëdha nga ana e investitorëve të huaj.

Afatet e zbatimit të imponuara nga G-20 & pasojat e paplanifikuara

Anëtarët e rinj të tregut të G-20-s theksuan vështirësitë në përmbushjen e afateve të zbatimit të vendosura nga hartuesit e politikave globale,

sidomos në raport me kërkesat e G-20 për reformat e derivateve OTC, të tilla si shtytja për tregtimin në bursë të derivateve të standardizuara, kleringu qendror i detyrueshëm, raportimi i transaksioneve të regjistruara të tregtimit dhe kërkesat e marzhit. (*The push for exchange trading for standardized derivatives, mandatory central clearing, reporting of transactions to trade repositories (TRs) and margin requirements.*) Kjo rrit sfidat në raport me ekonominë e shkallës, menaxhimit të kolateralit, dhe veçanërisht likuiditet. Megjithatë, disa anëtarë theksuan se derivatet OTC, infrastrukturën e tregut financiar (FMI) të tilla si CCPs (*Central Counterparties*) – Kundërpartit qendrore dhe TRs (*Trade Repositories*) – Regjistrat e Tregtimit dhe kërkesat e nevojshme të menaxhimit të rrezikut janë tashmë në vend, në përputhje me kërkesat e G-20. Një shqetësim i madh ishte edhe rritja e ndikimit jashtë territorial, i cili vjen nga aplikimet e “ekuivalencave” dhe “përputhshmërisë së zëvendësuar” nga ana e ekonomive të zhvilluara në tregjet në zhvillim.

Përputhshmëria e zëvendësuar (*ang. substituted compliance*) lidhet me lejimin e tregtarëve të derivateve, që operojnë në SHBA, por nuk janë rezidentë, të zbatojnë rregullat e juridiksionit mëmë, sipas disa kushteve të përcaktuara dhe aty ku ka ngjashmëri midis kërkesave rregullatore të juridiksioneve përkatëse.

Nevoja për financimin e afatgjatë të bazuar tek tregu

Anëtarët njohën qartë nevojën për të përsheptuar përpjekjet për thellimin e mëtejshëm të tregjeve të kapitalit në juridiksione e tregjeve në zhvillim, përmes rritjes së diversitetit produktit dhe duke siguruar qasje të vazhdueshme në financim e tregut. Ndër zonat e identifikuar janë zhvillimi i tregjeve të obligacioneve të korporatave, Securitization dhe financimin i SME-ve.

Financimi i SME-ve është parë si një komponent i rëndësishëm i financimit afatgjatë të bazuar në treg. Mungesa e dëshirës së investitorëve institucionalë për investimet në SME-të, u ritheksua si një shqetësim. Kjo është kryesisht e lidhur me çështje të mbrojtjes së investitorëve dhe kulturës së dobët të qeverisjes korporatave. Është sugjeruar, se segmente të veçanta të tregut mund të jetë krijuar për SME-të, në kuadër të tregut të kapitalit, ku ata mund të rritet dhe të arrijnë një nivel pjekurie, para se të bëhen subjekte të listuara publikisht. Nevoja për zhvillimin e kapitaleve, u theksua edhe si një mjet për të nxitur inovacione dhe ide të reja, dhe për të ndërtuar një rrugëtim të shëndetshme të kompanive për listim të mundshme në të ardhmen.

Zhvillimet teknologjike

Shpejtësia e rritur e tregtimit dhe zhvillimet e tjera që përfshijnë zhvillimet teknologjike, sjellin sfida për rregullatorët. Tregtimi me frekuencë të lartë, *tregtimi algoritmik* dhe disa çështje të lidhura me mediat sociale u nënvizuan si shqetësime të anëtarëve. Rregullatorët duhet të sigurojnë që personeli i tyre mbikëqyrës është i pajisur siç duhet dhe i trajnuar me ekspertizën e nevojshme për të adresuar çështjet që janë të lidhura zakonisht me përdorimin e teknologjisë dhe sistemet për tregtimin, ashtu si edhe për mbledhjen e fondeve.

Aktivitetet financuese në turmë (*ang. crowd*)

Aktivitetet financuese *crowd* dhe natyra e rritjes së shpejtë të aktiviteteve të tilla financuese, u evidentua si një shqetësim.

Financimet në turmë (*ang. Crowd Funding*) janë përdorimi i sasive të vogla të kapitalit nga një numër i madh individësh për të financuar sipërmarrje të reja të biznesit. *Crowd Funding* përdor aksesit e lehtë nëpërmjet rrjeteve të gjera të

Anëtarët njohën qartë nevojën për të përsheptuar përpjekjet për thellimin e mëtejshëm të tregjeve të kapitalit në juridiksione e tregjeve në zhvillim, përmes rritjes së diversitetit produktit dhe duke siguruar qasje të vazhdueshme në financim e tregut

miqtë, familjes dhe kolegëve duke përdorur mediat sociale si *Facebook*, *Twitter* dhe *LinkedIn* për të shpërndarë informacionin lidhur me çeljen e një biznes të ri dhe për të tërhequr investitorët. *Crowd Funding* ka mundësinë për të rritur sipërmarrjen duke zgjeruar grupin e investitorëve me fondet e të cilëve mund të dilet përtej rrethit tradicional të pronarëve, të afërmve, bizneseve të sipërmarrjes.

Ndërsa financimi *crowd* siguron përfitime duke zgjeruar qasjen drejt kapitalit, duke ulur koston e mbledhjes së kapitalit dhe që mund të përdoret nga bizneset dhe sipërmarrësit si mënyra marketingu, sjell me vete edhe shqetësime të tilla në rritje si mashtrimi, likuiditeti apo rreziqet e biznesit të vogël, si dhe çështjet që lidhen me transparencën dhe kthimin e kapitalit që nuk i përmbush pritshmëritë. Sfida për rregullatorët do të jetë hartimi ose miratimi i politikave të përshtatshme dhe të kuadrit rregullator që lehtëson financimin e kapitalit të rrezikut, si dhe ofron mekanizma të përshtatshëm për mbrojtjen e investitorëve.

Raportimi financiar

Është tashmë e pranuar gjerësisht nevoja e konvergjencës së standardeve të kontabilitetit dhe po punohet në mënyrë të vazhdueshme drejt arritjes së një pakete të vetme standardesh globale të kontabilitetit. Përkundër përpjekjeve për konvergjencën e të tilla standardeve, ka disa shqetësime më shumë për sasinë e informacionit se sa cilësinë e tij. Rregullatorët duhet të jenë të vetëdijshëm se shumë informacion mund të çojë në “mbingarkesë” të informacionit dhe për pasojë në mungesën e transparencës. Investitorët, si përdoruesit përfundimtarë të informacionit, duhet të jetë në gjendje të lexojnë lehtësisht dhe të kuptojnë pasqyrat financiare.

LAJMET NGA RAJONI

AZERBAJXHAN

www.xprimm.com

Kërkesa të reja për masën e kapitalit për kompanitë e sigurimit do të praqiten së shpejti në Azerbajxhan.



Azerbajxhani numëron 28 shoqëri sigurimit dhe një risigurimi. Aktualisht, kapitali minimal i kërkuar kompanive të sigurimit është fiksuar në nivelin e 5 milionë AZN (*Azerbaijani Manat*- monedha azerbaxhanase) dhe 10 milionë AZN për kompanitë e risigurimit. Ministria e Financave e Azerbajxhanit synon të rritet gradualisht kërkesa për kapitalin minimal deri në 10 milionë AZN për shoqëritë e sigurimit dhe 20 milionë AZN për ato të risigurimit.

Ndërsa shumë sigurues e konsiderojnë të pamundur që kërkesat për rritjen e masës së kapitalit minimal të jetë kaq drastike. Që nga 1 korriku, kapitali i përgjithshëm i kompanive të sigurimit në Azerbajxhanit arriti në 265.776 milionë AZN. (1 AZN = 0.954 euro)

Ministria e Financave e Azerbajxhanit synon të rritet gradualisht kërkesa për kapitalin minimal deri në 10 milionë AZN për shoqëritë e sigurimit dhe 20 milionë AZN për ato të risigurimit

KROACI

www.xprimm.com

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 siguruesit kroatë arritën një total të primeve të shkruara bruto prej 4.9 milion dollarë HRK (Croatian Kuna, monedha vendase) pothuajse të barabartë me atë të regjistruar në 6-mujorin e parë të vitit 2012. Sigurimi i Jetës pati të gjithë meritën për këtë trend pozitiv, duke treguar një rritje 5.9% në monedhën vendase, ndërsa primet e shkruara bruto për sigurimet e Jo-Jetës ranë me 1.4%.



Primet e shkruara bruto për sigurimin e Jetës arritën në 1.23 bilion HRK (166 milionë euro). Linjat tradicionale të sigurimit të Jetës regjistruan dinamikën më të mirë: të tilla si rritja e primit të shkruar bruto për linjën online të anuiteve të sigurimit regjistroi 120%. Në të njëjtën kohë, marrja në sigurim për njësi të lidhura me produktet e sigurimit u ulën me 6.3%.

Në sigurimet e Jo-Jetës, Sigurimi Kasko dhe klasat e sigurimeve të pronës nga dëmtimet regjistruan performancën më të keqe.

MOLDAVI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave paraprake financiare nga Komisioni Kombëtar i Tregjeve Financiare të Moldavisë (NCFM), volumi i primeve të shkruara bruto në tregun moldav të sigurimeve gjatë 6-mujorit të parë 2013 arriti 571.5 milion MDL (Moldovan leu, monedha moldave), 35.4 milion euro ose 14% më shumë se një vit më parë. Gjithashtu, kompanitë kanë paguar dëmet e pretenduara që arrijnë në 196.6 milion MDL (12.2 milion euro), duke shënuar një rritje 5% në terma vjetorë.



Klasat e sigurimeve motorike, MTPL, dhe Kartoni Jeshil arritën në 235.4 milion MDL vlerë të primeve të shkruara bruto (14.6 mil euro). Në këto klasa Kartoni Jeshil u rrit me 10.2% më shumë se vitin e kaluar. Në të njëjtën kohë, kompanitë e sigurimeve kanë paguar dëme në segmentin e sigurimit MTPL prej afro 41 milionë MDL (2.54 milion euro) ose 4% më pak se vitin e kaluar. Vlera e dëmeve të paguara të Kartonit Jeshil arriti 31.3 MDL (1.9 milion euro) me rritje prej 12.2 % më shumë se viti i kaluar.

Në sigurimet e Jetës vlera e primeve të shkruara bruto për gjysmën e parë të vitit 2013 mbeti nën 200 milionë euro për të pestin vit radhazi

RUMANI

www.xprimm.com

Tregu rumun i sigurimeve në gjysmën e parë të vitit 2013 arriti në afro 1 miliard euro vlerë të primeve të shkruara bruto. Sipas të dhënave paraprake, në 6-mujorin e parë 2013 primet e shkruara arritën përafërsisht 990 milionë

euro ose 3.9% më shumë në krahasim me 6-mujorin e parë të 2012. Megjithatë, e krahasuar me janar-qershor 2008, që cilësohet si kulmi i periudhës së tregut rumun të sigurimeve, kompanitë kanë ende për të rifituar 200 milion euro në vlerën e primeve të shkruara bruto.



Në sigurimet e Jo-Jetës, vlera e primeve të shkruara bruto arriti në 793 milionë euro, duke përfaqësuar 80% të primeve të të gjithë tregut të sigurimit. Nxitësi kryesor i rritjes së biznesit të sigurimit të Jo-Jetës ishte segmenti i sigurimit të pronave. Kështu, për klasën e “zjarrit dhe rreziqet shtesë “ u arrit një normë 16.3%. Sigurimet motorike, mbajnë ende peshën kryesore në portofolin e tregut (50.1% e primeve të shkruara bruto) regjistruan një normë pozitive të rritjes prej 4.4 %.

Në sigurimet e Jetës vlera e primeve të shkruara bruto për gjysmën e parë të vitit 2013 mbeti nën 200 milionë euro për të pestin vit radhazi.

TURQI

www.xprimm.com

Kushte tërheqëse në tregun e sigurimit të Turqisë pritet të nxisin investitorët e huaj gjatë katër viteve të ardhshme. Sipas një hulumtimi nga *Timetric*, sigurimi i detyrueshëm pritet të udhëheqë në industrinë e sigurimit të Jo-Jetës në Turqi deri në 2017 me futjen e produkteve të reja dhe me inkurajimin e investimeve nga qeveria në këtë sektor.



Vendndodhja e Turqisë e bën atë të prirur për tërmete. Bashkësigurimi Turk nga Katastrofat (Turkish Catastrophe Insurance Pool) është themeluar në vitin 1999 për t'u marrë me rreziqet nga fatkeqësitë natyrore. Sigurimi i detyrueshëm nga tërmetet u prezantua në vitin 2008.

Produktet e tjera të sigurimit të detyrueshëm përfshijnë sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësive profesionale për mjekët. Ndryshimet e mëtejshme në ligjin e sigurimit nga katastrofat dhe investimet në sektorin privat pritet të zgjerojnë mbulimin me sigurime të detyrueshëm deri në 2017.

Norma e ulët e penetrimit të sigurimit prej 1.35% në vitin 2012 në Turqi e krahasuar kjo me mesataren evropiane prej 7.6%, pritet të tërheqë interesimin e siguruesve të huaj, pasi ajo nënkupton një mundësi tërheqëse për produktet e reja të sigurimit dhe bizneset.

Për këtë numër punuan:

R. Guri, D. Kalaja, P. Berberi, R. Eltari, Dh. Hazbiu, E. Beqir-Aga, E. Kokona

Norma e ulët e penetrimit të sigurimit prej 1.35% në vitin 2012 në Turqi e krahasuar kjo me mesataren evropiane prej 7.6%, pritet të tërheqë interesimin e siguruesve të huaj